



PROCESVERBAL X/2024

I mbajtur me rastin e mbledhjes së X(dhjetë) për vitin 2024 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 23.10.2024
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Nënkryetarja e Komunës znj. Mihrije Suka
Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit;
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-56304;
4. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-shtator 2024;

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit dhe thotë që në këtë moment na ka ardhë një pikë shtesë nga Drejtoria e Pronës.Ia jep fjalën Armend Krasniqit.

Armend Krasniqi - përshëndet të pranishmit dhe thotë që është një kërkesë specifike ngjit me tri parcella ku është e paraparë që të bëhet një bllok ndërtimor ndërsa në të njëjtin pozicion pothuaj e kemi me HZK që është parapa rrugë.Nëse i hym shpronësimit dhe ky me i marr para komunës,më mirë e bëjmë kompenzimin sepse kemi qindra lëndë që kanë fillu të shpronësohen dhe po e dëmtojnë buxhetin e komunës.I japim 221m dhe i marrim 221m në Suharekë.Kërkesat të cilat po na ofrohen është mirë me i kry sepse këtu direkt fiton komuna dhe nuk dëmtohet komuna sepse vlerën e cakton dikush tjetër dhe komplet si procedurë shkon në Ministri e cila e jep edhe vlerësimin.Unë ju kisha lut ta përkrahni.

Kryesuesi - për ku bëhet fjalë?

Armend Krasniqi - rruga Vilson në Suharekë,përballë ETC-së.Është e domosdoshme me qu tutje.

Kryesuesi - ne kemi fut pika të rendit të ditës shtesë dhe më së shumti janë pika nga ju mirëpo është një rregullore në fuqi që na detyron neve patjetër 7 para mbledhjes me kompletu materialin edhe me dërgu.

Kur e ka parashtru kërkesën ky?

Armend Krasniqi - e ka parashtru disa ditë më herët por i kemi kërku disa sqarime shtesë dhe ne e kemi përgatit sot.

Kryesuesi - nuk dua që një praktikë e tillë të vazhdoj por ne do ta diskutojmë dhe do të mundohem ta hedh në votim.

Armend Krasniqi - mos e fut pikën për interesa të mia por për interesa madhështore të komunës.

Kryesuesi - unë nuk di se për ku po bëhet fjalë.Nuk e ka vendimin,certifikatën e pronës,kopjen e skicës.

Urim Suka - unë nuk kam material përpara dhe nuk të kuptova asgjë edhe pse ndoshta ti e ke sqaru mirë. Praktika të tilla kemi bërë plot dhe nuk jam kundra asaj nëse është interes publik por unë nuk po e shoh askund urgjencën dhe nuk po e kuptoj insistimin tënd.Mund ta sjellësh muajin tjetër.

Armend Krasniqi - unë e kam propozu dhe është interesi jetik me realizu një projekt të tillë.Kurr mos e votoni por detyra ime është me elaboru dhe cili është interesi i komunës këtu.

Urim Suka - unë nuk e mbështes një propozim të tillë për shkak se nuk kemi asnjë material.

Liridon Fandaj - a ka me ndodh edhe për rastet tjera kështu apo për dikënd ka me qenë shpronësimi e dikënd këmbimi? Mos ta bëjmë praktikë që për dikënd me qu shpronësim e për dikënd me bo këmbim.

Armend Krasniqi - komuna nuk ka interes me realizu këmbime por është shumë e mirë sepse nuk jep pare për me bë shpronësimin.Kemi qindra raste në gjykatë për shpronësime.Me shpronësime ka me qenë problem më i madh se sa me mjetet që na kanë marrë këtë vit.

Sanie Kuçi Rexhepaj - me miratimin e HZK-së është miratu një kushtetutë e re e komunës.Unë ju përgëzoj për këto iniciativa mirëpo nuk e arsyetoj pjesën tënde që po insiston me kalu në këtë Asamble për shkak se ne nuk e kemi materialin përpara.Ne duhet me analizu HZK-në,skicat e juaja,dokumentet që i keni përgatit për me dhënë një miratim të tillë për me kalu në Asamble.Për shkak të mangësisë së dokumenteve që i kemi përpara dhe mangësisë së sqarimeve,personalisht nuk më duket e arsyeshme me vazhdu në këtë Asamble.

Dardan Berisha - ne kemi votu shpeshëherë edhe pa material por varet prej interesave këtu qysh janë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - nuk është çështja e interesave por është çështja e kompletimit të lëndës.

Dardan Berisha - para 2-3 seancave sa më kujtohet mua,një pikë të njejtë e ka sjell drejtori.Pajtohem që mos të krijohet kjo lloj praktike por mos ti japim kahje që s'ka material.

Kryesuesi - ne e diskutuam dhe nuk dua ta bëjmë praktikë çdo seancë të KPF-së me pas pikë shtesë por kjo paska të bëj për me inicju procedurën.E hedh në votim pikën shtesë.

4 për,3 kundër,Miratohet pika shtesë për rend dite

Bulëza Kuçi - unë e kam një çështje për rihapjen e byfesë së shkollës "Destan Bajraktari".Ka 4-5 vite që byfeja është mbyll dhe nxënësat po janë shumë të rrezikuar.Na ka ndodh që i ka shkel vetura nxënësat. Është kërkesa e tetë që i vje Komunës dhe me datë16.10.2024 iu ka dërgu edhe Kryetarit.Nëse kemi mundësi me fut si pikë,me diskutu dhe me shiku a lejohet me u bë rihapja e byfesë.

Kryesuesi - me hapjen e shkollës "Destan Bajraktari" kjo byfe ka funksionu disa vite e pastaj është mbyll por unë mendoj që është çështje e DKA-së.Ia jep fjalën Zyrtarit ligjor për sqarime.

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor thotë që secila shkollë e ka këshillin drejtues të shkollës dhe këshilli drejtues e analizon dhe merr vendim çka me vepru me të.

Bulëza Kuçi - nëse është fjala për këshillin drejtues,ne brenda ditës e kryejmë këtë punë.Është kërkesa e 7 ose 8 që i vjen DKA-së dhe nuk kemi përgjigje.

Kryesuesi - unë jam në këshill drejtues në shkollën "7 Marsi" dhe për deri sa ka funksionu ajo,politika thotë me vazhdu rihapjen.

Dardan Berisha - në parim pajtohem me kërkesën e Bulëzës.Nëse ne e votojmë si Kuvend,a ndikon kjo apo jo?

Bulëza Kuçi - çështja është që sipas disa rregulloreve që kam bisedu me Drejtorin e Arsimit,nuk lejohet me hap byfe brenda objektit të shkollës.

Nënkryetarja - unë do ta marr parasysh.

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës me pikën shtesë.

6 për,1 apstenim,Miratohet rendi i ditës me pikën shtesë

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - pasi nuk ka vërejtje,e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet Pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Dardan Berisha - ky komision a ka me qenë me pagesë apo pa pagesë?

Kryesuesi - pa pagesë.E hedh në votm pikën 2.

5 për,2 apstenime,Miratohet pika 2

Pika 3. Sqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-56304;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - unë e kam ngrit këtë çështje njëherë te drejtori dhe drejtori thoshte se ke plotësisht të drejtë.Me sa unë e di,ne si Kuvend gati asnjëherë nuk kemi marrë vendim që për vitin paraprak cilat prona kemi me i dhënë në shfrytëzim.Ajo që më duket e çuditshme,ka plot lëndë tjera që ne e kemi marrë një vendim dhe Ministria e ka pranë dhe këtë nuk e ka pranë.Më duket keq prej Ministrisë dhe keq prej drejtorit që nuk e ka parapa me kohë.

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor thotë që Ministria ka thënë që nuk është në listën e pronave dhe nuk mund të jepet në shfrytëzim prona po që se nuk e ka një vendim paraprak.Vendimi paraprak është ky që e kemi marrë ne.Drejtori e ka publiku listën e pronave në dhjetor të vitit 2023 por fatkeqësisht kjo parcelë nuk ka qenë aty dhe ata e kanë konstatu që nuk është në listë dhe e kanë kthi në rishqyrtim për me shfuqizu.

Urim Suka - neve çdo muaj po na shfuqizohen vendime.

Armend Krasniqi - Duke pas parasysh rekomandimet që i ka bë një kompani që i monitoron mbledhjen e mbeturinave,ka konstatu që nuk ka më vend për me dhënë atë 10-15 vite dhe atëherë jemi mundu mos me publiku por me vendos një vend tjetër por sipas destinimeve të HZK-së nuk kemi mujt me gjet asnjë vend dhe kemi pas interes të përgjithshëm të komunës me vazhdu edhe 1 vit ose 2 deri sa të gjindet një alternativë tjetër dhe kjo është arsyeja se pse nuk ka qenë në listë të veçantë të pronës shoqërore.

Urim Suka - prona në dalje të Suharekës a ka qenë në listë të veçantë sepse ti ke thënë që nuk është në listë por bën me dhënë.

Armend Krasniqi - nuk e di saktësisht por besoj që ka qenë.

Liridon Fandaj - çka ka me ndodh me deponinë pasi atij i ka skadu kontrata dhe po vazhdon?

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor thotë që i mbyll inspeksioni.

Urim Suka - kur të afrohet kontrata me dal,ti procedurat duhet me i nis 3-4 muaj përpara.

Armend Krasniqi - nuk e kemi pas një zonë të caktuar dhe jemi mundu me gjet zonë tjetër.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-shtator 2024;

Kryesuesi - e elaboron pikën 4 dhe hap debatin.

Urim Suka - e kuptoj që është obligim i ekzekutivit çdo 3 mujor me raportu dhe me ja ofru kuvendit një pasqyrë të shpenzimit të buxhetit deri në këtë periudhë 9 mujore por ajo që mua më shqetëson është që po përcillet vazhdimisht,është se 20 % po del që janë shpenzu mjetet për investime kapitale dhe mua më duket e ulët sepse i bie që krejt shpenzimi i parasë po konvertohet tre muajt e fundit dhe mundësia për me hargju buxhetin keq është e madhe.A është praktikë normale apo është diçka që nuk është në rregull?

Fadil Hoxha - ZKF thotë që buxheti i projekteve kapitale nuk është shpenzu 20% por buxheti i projekteve kapitale në total është shpenzu 59.87 %.ZKF jep sqarime tutje sa i përket shpenzimit të buxhetit për këtë 9 mujor dhe thotë 20.24 % është i pashpenzuar në krahasim me alokimet.Po thua:a është me normalen? Nuk është shumë me normalen por është afër normales.

Urim Suka - 59.87 % është edhe si pasojë e përmbaruesit.

Fadil Hoxha - po, 1.041.000 janë të përmbaruesve që e ka rrit këtë përqindje por edhe mos t'i kish marrë përmbaruesi ndoshta 1 milion nuk i kishim shpenzu por 700.000 -800.000 i kishim shpenzu në mënyrë të rregullt.Këto probleme janë në nivel të Kosovës.

Liridon Fandaj - te granti qeveritar janë shpenzu 56.14 %,të hyrat vetanake janë shpenzu me një masë më të madhe se granti qeveritar.A do të ishte më mirë me i planifiku projektete edhe këto mjetet të grantit qeveritar nëse ato mbesin në fund të vitit dhe shkojnë suficit e të hyrat vetanake ne prap mundemi me i bartë.Ato janë të destinuara si projekte dhe ne nuk mundemi me i lëviz ato.

Fadil Hoxha - plan keshin e ka vetëm granti qeveritar dhe na ndodh që atë muaj e kemi një pagesë që do të ndodh p.sh. në tetor dhe ne kemi edhe vetanake për atë projekt.Tash në atë muaj është bë një shpenzim dhe ata nuk e kanë bë mirë dhe ai shpenzim nuk ka mund të merret prej grandit sepse mjetet kanë qenë të planifikuara ose më herët ose më vonë dhe ne për mos me mbajt shumë atë faturë e kemi përdor vetanaken.Kjo ka ndodh që janë shpenzu më shumë vetanaket se granti.

Kryesuesi - a do të ndalet trendi i përmbaruesave në vitin 2024 apo do të vazhdoj edhe në vitin 2025?

Fadil Hoxha - për momentin prej 3.229.000 që janë bë shpenzim,i kam në pritje prej 28 gushtit edhe 1.052.000.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

5 për,2 apstenime,Miratohet pika 4

Pika 5 shtesë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5 shtesë.

5 për,3 kundër,Miratohet pika 5 shtes

Takimi përfundoi: 14:10

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj